

TRANSPAROMETRI KOMUNAL

Janar – Qershor 2021





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2021 . KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center (OPC). Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI- dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

6

HYRJE

7

METODOLOGJIA

8

MATJA DHE POENTIMI

9

LISTA E INDIKATORËVE

11

VLERËSIMI I
TRANSPARENCËS SË
KOMUNAVE JANAR -
QERSHOR 2021

13

OBSERVIMET
KRYESORE

14

Komuna e Rahovecit

15

Komuna e Lipjanit

16

Komuna e Mitrovicës
Jugut

17

Komuna e Pejës

18

Komuna e Drenasit

19

Komuna e Gjakovës

20

Komuna e Skenderajt

21

Komuna e Hanit Elezit

22

Komuna e Prishtinës

23

Komuna e Malishevës

25

Komuna e Suharekës

26

Komuna e Ferizaj

28

Komuna e Kaçanikut

29

Komuna e Klinës

30

Komuna e Vushtrrisë

31

Komuna e Prizrenit

32

Komuna e Vitisë

33

Komuna e Podujevës

34

Komuna e Deçanit

35

Komuna e Gjilanit

36

Komuna e Istogut

37

Komuna e Kamenicës

38

Komuna e Graçanicës

39

Komuna e Shtimes

41

Komuna e Dragashit

42

Komuna e Junikut

44

Komuna e Obiliqit

46

Komuna e Fushë
Kosovës

47

Komuna e Parteshit

49

Komuna e Mamushës

51

Komuna e Mitrovicës
Veriore

52

Komuna e Shtërpces

53

Komuna e Kllopotit

55

Komuna e Zveqanit

56

Komuna e Leposaviq

57

Komuna e Novobërdës

58

Komuna e Ranillugut

60

Komuna e Zubin Potok

62

REKOMANDIMET



HYRJJE

Në vjeshtën e këtij viti, me organizimin e zgjedhjeve të rregullta lokale më 17 tetor, qeveritë në nivelin komunal do të përfundojnë mandatin e tyre 4-vjeçar. Që nga konstituiimi i organeve vetëqeverisëse lokale në fillim të vitit 2018, KDI ka monitoruar përmbushjen e standardeve ligjore për transparencë në shumicën e komunave të Republikës së Kosovës. Në vazhden e këtij angazhimi, KDI në partneritet me organizatat e shoqërisë civile pjesë të konsorciumit “Aleanca Qytetare për Transparencë” (AQT) ka nxjerrë edhe matjet e fundit, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 lidhur me performacën e 38 komunave të Kosovës.

Duke qenë një mjet praktik dhe sistematik për vlerësimin e transparencës komunale nga viti në vit, **Transparometri Komunal** ka ndikuar që shumica e institucioneve komunale, në mënyrë inkrementale të reflektojnë mbi të gjeturat e tij dhe të ndërmarrin hapa konkretë për përmirësimin e performancës së tyre. Përfundim këtu përbëjnë komunat me shumicë serbe, të cilat për shkak dhe rrethana kryesisht politike kanë stagnuar në përmbushjen e obligimeve dhe praktikave për transparencë, dhe qeverisje të mirë në përgjithësi.

Duke qenë se institucionet lokale janë instanca e parë ku qytetarët adresojnë kërkesat për zgjidhjen e problemeve të përditshme, transparenca dhe llogaridhënia e tyre mbasin parakushtet kryesore që ato të mund të qeverisin përgjegjshëm dhe në mënyrë efikase. Duke qenë të hapura dhe transparente, institucionet publike i kontribuojnë nxitjes së bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe institucioneve, duke mundësuar kështu pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje. Rrjedhimisht ndikojnë në rritjen e besimit të publikut në institucione.

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës garanton institucione transparente karshi qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisja lokale, ligji për qasje në dokumente publike, e udhëzime të tjera administrative legjitimojnë këtë garancion si dhe sigurojnë qytetarët me mjetet e nevojshme ligjore për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie nga institucionet e qeverisjes lokale në Kosovë.

KDI-ja shpreson që rezultatet e këtij Transparometri për periudhën janar – qershor 2021, do të vazhdojnë t'u shërbejnë komunave si udhërrëfyes dhe motivim për të ngritur performancën e tyre dhe për të kultivuar bashkëpunimin me qytetarët drejt një vendim-marrjeje më kualitative.



METODOLOGJIA

Ky hulumtim është realizuar në të gjithë 38 komunat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar – qershor 2021. Performanca e institucioneve komunale gjatë vitit 2021 është vlerësuar në bazë të 44¹ indikatorëve, bazuar në metodologjinë e Transparency International dhe në praktikat shumëvjeçare të KDI. Matjet për periudhën Janar – Qershor 2021, janë realizuar nga konsorciumi i OJQ-ve “Aleanca Qytetare për Transparencë” i përbërë nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe nëntë (9) organizata lokale partnere: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, Iniciativa Qytetar Skenderaj (IQS), Forumi i Organizatave Jo-qeveritare Kaçanik (FOJK), Shoqata e Intelektualëve të Pavarur (SHIP), SHL-Kosova, Rrjeti i OJQ-ve AVONET, Initiative for Social Education – ISEP si dhe OJQ SOFRA.

Procesi i vlerësimit të përmbushjes së indikatorëve për 34 komunat me shumicë shqiptare, ka ndjekur një metodologji standarde duke shfrytëzuar metodat adekuate për mbledhjen e të dhënave. Janë monitoruar ueb faqet zyrtare të komunave (të administruara nga Ministria e Administratës Publike), janë realizuar intervista me akterë komunalë, janë dërguar kërkesa tek autoritetet lokale për qasje në informata/dokumente publike ndërsa është monitoruar edhe puna e institucioneve komunale.

Për shkak të kontekstit politik që mbizotëron në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës², vlerësimi i indikatorëve është bazuar në metodologji të njëjtë por duke shfrytëzuar burime alternative siç janë ueb faqet jozyrtare të këtyre komunave: <https://www.ezubinpotok.com/>; <http://www.ezvecan.com/>; <https://www.eleposavic.com/> dhe <http://www.esevenamitrovica.com/>, të cilat administrohen nga OJQ-ja Neëë Social Initiative³ me seli në Mitrovicën e Veriut.

Korniza ligjore e cila është konsultuar gjatë përcaktimit të indikatorëve përfshin: Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike; Ligji Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve; Udhëzimi Administrativ (MPL) NR. 03/2020 Për Transparencë në Komuna; Udhëzimin Administrativ të MAP nr. 01/2015 për Ueb faqet e institucioneve publike; Vendimin e Qeverisë 07/87 mbi miratimin e Kartës për Hapjen e të Dhënave; Rregulloren (QRK) nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.


¹ Për shkak të periudhës kur është bërë matja nuk ka qenë I mundur vlerësimi i Katër (4) indikatorëve (23, 43, 46 dhe 47).

² Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovica e Veriut, Zveçan

³ <http://neesocialinitiative.org/>

MATJA DHE POENTIMI

Lidhur me secilin indikator, komunat janë poentuar me **0 deri në 2 pikë**, varësisht nga niveli i informacionit që ato kanë ofruar apo sa ka qenë i qasshëm. Komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë informacion lidhur me një indikator të caktuar janë poentuar me **0 pikë**. Kur informacioni ka qenë i pjesshëm, komunat janë poentuar me **1 pikë**, ndërsa kur informacioni ka qenë i plotë, komunat janë poentuar me **2 pikë**.



Rezultati maksimal për një komunë për të gjithë 44 indikatorët është




88 PIKË

Rezultati minimal për një Komunë për të gjithë indikatorët është



0 PIKË



LISTA E INDIKATORËVE⁴:

- 1 A janë publikuar njoftimet për seancat e Kuvendit të Komunës dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së seancave?
- 2 A i është bashkëngjitur njoftimeve për seanca të Kuvendit të Komunës materiali përcjellës?
- 3 A është bërë informimi i publikut për seancat e Kuvendit të Komunës në vendet më të frekuentuara nga qytetarët, përmes mediave dhe rrjeteve sociale?
- 4 A janë publikuar njoftimet për mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve?
- 5 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës 5 seanca të rregullta gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit, siç parashihet me ligj?
- 6 A janë mbledhjet e Komiteteve të përhershme të hapura për publikun?
- 7 A janë të publikuara në ueb faqen e komunës të dhënat për të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (emri, mbiemri, data e lindjes, emaili, adresa e banimit, numri i telefonit, subjekti politik)?
- 8 A mund të gjendet në ueb faqen zyrtare të komunës një historik i shkurtër për komunën?
- 9 A e ka të publikuar në ueb faqe Kuvendi i Komunës Planin e tij të punës?
- 10 A ka Kuvendi i Komunës një Plan të veprimit për transparencë dhe a është i njëjti publik?
- 11 A janë të publikuara video-linqet e seancave të Kuvendit të Komunës pas mbajtjes së tyre?
- 12 A ka publiku qasje në draft rregulloret e Kuvendit të Komunës?
- 13 A janë publike rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës?
- 14 A publikohen procesverbalet e seancave të Kuvendit të Komunës dhe rezultatet e votimit mbi pikat e rendit të ditës?
- 15 A ka qasje publiku në vendimet e Kuvendit të Komunës?
- 16 A janë seancat e Kuvendi të Komunës të hapura për publikun?
- 17 A transmetohen seancat e Kuvendit të Komunës drejtpërdrejtë, dhe nëse po, përmes çfarë platformave?
- 18 A ka thirrur në raportim Kuvendi i Komunës ose komitetet Kryetarin e Komunës?
- 19 A ka thirrur në raportim Kuvendi i Komunës ose komitetet drejtorët e drejtorive?
- 20 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës diskutime mbi shpenzimet tremujore brenda afateve ligjore?
- 21 A janë të gjitha dokumentet publike të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 22 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës diskutime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)?
- 23 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës gjatë muajit shtator diskutime publike për buxhetin vjetor për 2021?
- 24 A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?

⁴ Indikatorët 23, 43, 46 dhe 47 janë të pezulluar gjatë kësaj periudhe të vlerësimit



- 25 A janë të publikuara informatat kontaktuese dhe biografia e Kryetarit/es në ueb faqen zyrtare?
- 26 A janë të publikuara informatat kontaktuese dhe biografitë e drejtorëve të drejtorive komunale në ueb faqen zyrtare?
- 27 A ka në ueb faqe informacione lidhur me çështjet e integritimit në BE dhe ndikimin që ato kanë në qeverisjen komunale?
- 28 A publikohen konkurset e punësimeve, përfshirë kriteret?
- 29 A disponon komuna me koordinator përgjegjës për qasje në dokumente zyrtare?
- 30 A disponon komuna me një mekanizëm përcjellës për regjistrimin dhe statusin e kërkesave të qytetarëve?
- 31 A ofron komuna qasje të papenguar në dokumente zyrtare?
- 32 A është publik plani vjetor i Kryetarit/es të komunës?
- 33 A është ueb faqja zyrtare e komunës e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 34 A janë të gjitha vendimet e Kryetarit/es të komunës të qasshme për publikun?
- 35 A është publik borxhi komunal?
- 36 A është publike lista e pronave komunale të dhëna me qira ose në shfrytëzim?
- 37 A janë publike të dhënat për të hyrat vetanake të komunës?
- 38 A janë të qasshme të dhënat e komunës në formatin e Open data (versione të shfrytëzueshme dhe të përpunueshme)?
- 39 A shfrytëzon komuna rrjetet sociale për të komunikuar dhe plasuar informata për qytetarët?
- 40 A janë publike kontaktet e Zyrtares/es për informim?
- 41 A ka komuna në dispozicion një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët?
- 42 A disponon/publikon komuna me një listë mbi shërbimet që ajo i ofron për qytetarët?
- 43 A disponon/publikon komuna materialin paraprak për dëgjimet buxhetore dhe takimet publike?
- 44 A ka organizuar komuna takimet publike të parapara me ligj?
- 45 A publikon komuna aktivitetet e saj në ueb faqe?
- 46 A ka organizuar ekzekutivi i komunës dëgjime buxhetore për buxhetin vjetor 2021 sipas afateve ligjore?
- 47 A disponon/publikon komuna procesverbale nga dëgjimet buxhetore?
- 48 A është publikuar në ueb faqe buxheti komunal për vitin 2021?



VLERËSIMI I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE JANAR - QERSHOR 2021

Komuna	Pikët	Përqindje
Rahovec	83	94.32
Lipjan	81	92.05
Mitrovicë e Jugut	81	92.05
Pejë	81	92.05
Drenas	78	88.64
Gjakovë	77	87.50
Skenderaj	75	85.23
Hani i Elezit	74	84.09
Prishtinë	73	82.95
Malishevë	71	80.68
Suharekë	71	80.68
Ferizaj	70	79.55
Kaçanik	69	78.41
Klinë	69	78.41

|||||

Komuna	Pikët	Përqindje
Vushtrri	68	77.27
Prizren	68	77.27
Viti	67	76.14
Podujevë	67	76.14
Gjilan	66	75.00
Deçan	64	72.73
Istog	62	70.45
Kamenicë	62	70.45
Graçanicë	60	68.18
Shtime	59	67.05
Dragash	57	64.77
Junik	55	62.50
Obiliq	54	61.36
Fushë Kosovë	52	59.09
Partesh	49	55.68
Mamushë	45	51.14
Mitrovicë e Veriut	43	48.86
Shtërpcë	43	48.86
Klllokot	42	47.73
Zveçan	41	46.59
Leposaviq	40	45.45
Novo Bërdë	37	42.05
Ranillug	36	40.91
Zubin Potok	32	36.36

|||||



OBSERVIMET KRYESORE

Matjet sistematike të KDI-së por edhe këto të fundit, dëshmojnë që Komunitet e Kosovës, nga viti në vit kanë demonstruar angazhim praktik në adresimin e mangësive dhe në përmirësimin e performancës në indikatorë të caktuar të Transparencës Komunal. Përfundimisht, kjo qasje ka munguar tek komunitet që qeverisen nga komunitetet joshumicë në Kosovë, të cilat për më tepër, në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2021 kanë dhënë shenja të theksuara të regresit në transparencë.

Nga gjithsejt 38 komunitet e Republikës së Kosovës, 10 prej tyre gjatë periudhës vlerësuese janar – qershor 2021 kanë mirëmbajtur një standard linear në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në kuotën prej mbi 80%. Ndonëse mund të vlerësohet si trend pozitiv, këta indikatorë janë bazikë dhe përgjithësisht reflektojnë përmbushjen e obligimeve ligjore që komunitet kanë në raport me transparencën ndaj publikut.

Sfidat të cilat komunitet i kanë potencuar në mospërmbushjen e indikatorëve lidhen me mungesën e bashkëpunimit ndër-institucional, me theks ndërmjet komunitet dhe institucioneve qendrore, si janë ministritë. Menaxhimi i ueb faqeve të komunitet nga niveli komunal duhet të adresohet nga niveli qendror me qëllim të lehtësimin të procesit nga ana e komunitet që në një mënyrë do të reflektonin në përmbushjen e 100 % të indikatorëve vlerësues.

Komunitet i kanë kushtuar rëndësi të shtuar përmbushjes së indikatorëve që vlerësojnë transparencën e punës së kuvendit të komunitet. Përmirësim i theksuar, nga 26% (në vitin 2020) në 35% (në gjysmën e parë të vitit 2021) është shënuar në bërjen publike të materialeve për mbledhjet e kuvendit të komunitet. Po ashtu, një nga indikatorët që kanë reflektuar komunitet në përmirësimin mbetet ai i publikimit të video-linçeve të mbledhjeve të kuvendeve të komunitet, duke rritur transparencën e punës së kuvendit të komunitet. Në vitin 2020, ky indikator ishte përmbushur vetëm 48 % nga ana e komunitet derisa gjatë periudhës vlerësuese janar- qershor 2021, ky indikator është rritur në 72 %. Kjo rritje i atribuohet angazhimit të kuvendeve të komunitet

për të adresuar rekomandimet e dhënë për rritjen e transparencës komunale.

Kuvendet e Komunitet, në përgjithësi kanë rritur kërkesën për llogaridhënie ndaj Kryetarëve të Komunitet në masën prej 10% krahasuar me matjet e vitit të kaluar 2020.

Një nga të dhënat pozitive në vlerësimin e transparencës së komunitet gjatë kësaj periudhë mbetet edhe përfshirja e kuvendeve të komunitet në procesin e organizimit të dëgjimeve ve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB). Edhe ky indikator ka shënuar progres gjatë periudhës së parë të vitit 2021, ku nga 28 % që ishte përmbushur në vitin 2020, gjatë periudhës së parë të vitit 2021 ky indikator është përmbushur në vlerën prej 39 %, pra me një rritje prej 11 %. Nga kjo e dhënë, vërehet që kuvendet e komunitet kanë arritur të kuptojnë rëndësinë dhe pjesëmarrjen e tyre në proces të planifikimit të KAB, por mbetet akoma për tu angazhuar në vitin vijues.






Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit, gjatë periudhës vlerësuese (janar-qershor 2021) ka përmbushur plotësisht 41 nga 44 indikatorët e Transparometrit, duke u renditur në mesin e komunave më transparente.

Në dy (2) indikatorë që kanë të bëjnë me a) publikimin e të dhënave/dokumenteve në gjuhët zyrtare në nivel lokal dhe b) azhurnimin e të dhënave në uebfaqen zyrtare të komunës⁵ ka ofruar të dhëna të pjesshme, duke pamundësuar transparencë të plotë sa i përketë ofrimit të informacioneve në gjuhët zyrtare përmes ueb faqes të komunës.

Indikator i vetëm që nuk është përmbushur lidhet me ofrimin e të dhënave/dokumenteve publike në formatin "Open Data", format ky që lejon përpunimin dhe shpërndarjen më të lehtë të këtyre të dhënave.

Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Rahovecit është vlerësuar me tetëdhjetë e pesë (85) pikë, respektivisht ka arritur të përmbushë indikatorët në masën 96.59%.



⁵ Lajmet, njoftimet për publikun etj




Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit, ka rezultuar të jetë në mesin e komunave që ka arritur të përmbushë indikatorët vlerësues të transparencës komunale. Gjatë periudhës vlerësuese nga dyzet e katër (44) indikatorë, në tridhjetë e nëntë (39) indikatorë ka arritur transparencë të plotë, në dy (2) indikatorë të mos ofrojë transparencë fare duke u vlerësuar me zero (0) pikë dhe në tre (3) indikatorë ka ofruar informacione të pjesshme duke u vlerësuar me një (1) pikë. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Lipjanit është vlerësuar me tetëdhjetë e një (81) pikë apo vetëm 92.05 % kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Gjatë kësaj periudhë, komuna e Lipjanit nuk ka arrit të përmbushë dy (2) indikatorë, duke u vlerësuar me mungesë të transparencës së plotë. Indikatorët e tillë janë: mos publikimi i informatave nga takimet dhe aktivitetet më Këshillat Lokal si dhe mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data".

Komuna e Lipjanit, me vlerësim të pjesshëm është vlerësuar edhe në tre (3) indikatorë të tjerë përkatësisht në mos ofrimin e një mekanizmi paralel, ku qytetarët do të kishin mundësin e përcjelljes së statusit të kërkesave të tyre, mos respektimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal në publikimin e dokumenteve, mos azhurnimit me të dhënat bazike të publikuara në ueb faqen zyrtare të komunës, duke pa mundësuar transparencë të plotë në qasjen në ueb faqen e komunës në gjuhët zyrtare.






Komuna e Mitrovicës Jugut

Komuna e Mitrovicës së Jugut ka vazhduar të mbaj standardin në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Kjo komunë, gjatë periudhës vlerësuese janar – qershor 2021, nga dyzet e katër (44) indikatorë vlerësues, ka rezultuar që në tridhjetë e tetë (38) indikatorë të ofrojë transparencë të plotë , në pesë (5) indikatorë të vlerësohet me transparencë të pjesshëm si dhe në një (1) indikatorë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Mitrovicës së Jugut është vlerësuar me tetëdhjetë e një (81) pikë apo vetëm 92.05% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Mitrovicës Jugore me zero pikë është vlerësuar në ofrimin e informatave në formatin e "Open Data", format ky i cili mundëson qytetarët ti përpunojnë këto të dhëna. Komuna e Mitrovicës së Jugut duhet të krijojë mundësi dhe hapësirë për publikimin e të dhënave në formatin e tillë.

Komuna e Mitrovicës së Jugut, me vlerësim të pjesshëm është vlerësuar edhe në pesë (5) indikatorë të tjerë përkatësisht në: mos ofrimin e qasjes në gjitha draft Rregulloret komunale që janë miratuar nga kuvendi i komunës, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në afatet kohore të përcaktuara me legjislacion, mos azhurnimit me të dhënat bazike të publikuara në ueb faqen zyrtare të komunës, qasje kjo qe ka pa mundësuar transparencë të plotë në qasjen në ueb faqen e komunës në gjuhët zyrtare, mos organizimi i dëgjimit për KAB ekskluzivisht nga ana e KPF-së / kuvendit, nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve.




Komuna e Pejës

Komuna e Pejës mbetet ndër komunat që nga viti në vit ka vazhduar me përmbushjen e indikatorëve vlerësues të matjes së transparencës komunale. Gjatë periudhës vlerësuese nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që ne tridhjet e nëntë (39) indikatorë të jetë transparente, në tre (3) me transparencë të pjesshëm si dhe në dy (2) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Pejës është vlerësuar me shtatëdhjetë e nëntë pikë (81) pikë apo 92.05 % ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Po ashtu, komuna e Pejës është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimin dhe qasja në listën e pronave të dhëna me qira, si dhe komuna e Pejës ka vazhduar të mos ofrojë të dhënat në formatin "Open Data".

Komuna e Pejës, pjesërisht transparente është treguar në tre (3) indikatorë e njëjta nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve, mungesa e publikimit të gjithë dokumenteve në gjuhët zyrtare si dhe mos azhurnimi i ueb faqes në gjuhët zyrtare dhe si e tillë është vlerësuar me vetëm një (1) pikë.






Komuna e Drenasit

Komuna e Drenasit, mbetet ndër komunitat që ka përmbushur në masë të konsiderueshme indikatorët vlerësues të transparometrit komunal, por krahasuar më vitin 2020, gjatë periudhës vlerësues janar-qershor 2021, kjo komuna ka pasur në rënie të vogël. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, gjatë periudhës janar – qershor 2021, ka rezultuar që kjo komunë në tridhjetë e gjashtë (36) indikatorë të ofrojë transparencë të plotë, në gjashtë (6) indikatorë me transparencë të pjesshëm si dhe në dy (2) indikatorë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Drenasit është vlerësuar me shtatëdhjetë e tetë (78) pikë apo 88.64 % ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Ueb faqet e institucioneve publike⁶, institucionet publike ndër të tjera kanë për obligim të ofrojnë informata të mjaftueshme për ofrimin dhe procedurat e marrjes së shërbimeve nga institucioni. Komuna e Drenasit në këtë indikatorë është vlerësuar pjesërisht transparentë për shkak se disa drejtori komunale kanë mungesë të informatave të përgjithshme në marrjen e shërbimeve të

tilla. Me vlerësim të pjesshëm është vlerësuar edhe në pesë (5) indikatorë të tjerë përkatësisht në mos ofrimin e një mekanizmi paralel, ku qytetarët do të kishin mundësin e përcjelljes së statusit të kërkesave të tyre, mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për proceset dhe përmbushjen e obligimeve të nivelit lokal në proceset integruar evropiane, mos respektimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal në publikimin e dokumenteve, mos azhurnimit me të dhënat bazike të publikuara në ueb faqen zyrtare të komunës si dhe mos publikimin e borxhit publik komunal në një dokument të veçantë. Gjatë kësaj periudhë, komuna e Drenasit nuk ka arrit të përmbushë dy (2) indikatorë, duke u vlerësuar me mungesë të transparencës së plotë. Indikatorët e tillë janë: mos përfshirja e Kuvendit Komunal në dëgjimet për KAB, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data" si dhe mos publikimi i borxhit publik komunal. Komuna e Drenasit gjatë qershorit 2021, ka organizuar dëgjim buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), por këtë organizim e ka organizuar zyra e kryetarit të komunës, por jo edhe Kuvendi i Komunës apo Komiteti për Politik dhe Financa si autoritet në përfshirjen e organizmit të dëgjimit për KAB.



⁶ Shihe nenin 9 paragrafin 1.13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>




Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës mbetet në mesin e komunave që në vlerësimet e matjes së transparencës në vazhdimësi ka arritur të përmbushë pjesën dërmuese të indikatorëve vlerësues. Megjithatë, krahasuar me vitin 2020, gjatë periudhës vlerësuese janar – qershor 2021 kishte një rënie të lehtë në përmbushjen e indikatorëve përkatësisht nga 89.58 % në 87.5 %. Sa i përket periudhës vlerësuese janar – qershor 2021, nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në tridhjetë e gjashtë (36) indikatorë të jetë transparente, në pesë (5) me transparencë të pjesshëm si dhe në tre (3) indikatorë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësim-it, komuna e Gjakovës është vlerësuar me shtatëdhjetë e shtatë (77) pikë apo vetëm 87.5 % ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Gjatë kësaj periudhe, komuna e Gjakovës nuk ka arrit të përmbushë tre (3) indikatorë, duke u vlerësuar me mungesë të transparencës së plotë. Indikatorët e tillë janë: mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës në vitin 2021, mos publikimi i borxhit publik komunal në periudha

të caktuara kohore brenda raporteve tre mujore financiare si dhe nuk ka publikuar listën e pronave të dhëna me qira në ueb faqen zyrtare të komunës.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për piakt e rendit të ditës⁷, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Gjakovës nuk ka arritë të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me pjesërisht transparente. Me vlerësim të pjesshëm është vlerësuar edhe në pesë (5) indikatorë të tjerë përkatësisht në mos bashkëngjitjen e materialeve përcjellëse për gjitha seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe, mos ofrimin e dokumenteve publike në të gjitha gjuhët zyrtare, mos publikimin e raportit nga kërkesat për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për verifikimin e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve si dhe mos publikimin e dokumenteve të ndryshme në formatin e "Open Data" (disa nga dokumentet janë të publikuar në formatin e mundësisë së përpunimit të të dhënave).



⁷ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>


Komuna e Skenderajt

Komuna e Skenderajt, mbetet ndër komunitat që ka rritur transparencën krahasuar me vitin 2020. Derisa gjatë vitit 2020 kishte arritur të përmbushë 77.08 % të indikatorëve vlerësues, gjatë periudhës vlerësuese janar – qershor vërehet një rritje e ndjeshme në përmbushjen e indikatorëve me 85.23 %. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në tridhjetë e pesë (35) indikatorë të jetë me transparencë të plotë, në pesë (5) me transparencë të pjesshëm si dhe në katër (4) indikatorë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Skenderajt është vlerësuar me shtatëdhjetë e pesë (75) pikë apo 85.23% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Gjatë kësaj periudhë, komuna e Skenderajt nuk ka arrit të përmbushë katër (4) indikatorë, duke u vlerësuar me mungesë të transparencës së plotë. Indikatorët e tillë janë: mos organizimi i dëgjimit buxhetor për KAB nga kuvendi i ko-

munës, mos konsolidimi dhe publikimi i informatave për Këshillat Lokal, mos hapja e të dhënave në formatin e "Open Data", si dhe mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët e komunës.

Komuna e Skenderajt pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për proceset që ndërlidhen me integrimet evropiane (përveç emrit të zyrtarit, emailit dhe numrit të telefonit asnjë e dhënë tjetër nuk është e publikuar, mos publikimi i dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare, mos ofrii i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre, mos azhurnimi i plotë i ueb faqes në të gjitha gjuhët zyrtare,, si dhe mos ofrimi i një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun, nga ana e gjitha drejtorive komunale.




Komuna e Hanit Elezit

Komuna e Hanit Elezit edhe gjatë kësaj periudhë vlerësuese mbetet në top 10 komunat më transparente, e cila gjithashtu ka shënuar një rritje të përmbushjes së indikatorëve në këtë periudhë të vlerësimit krahasuar me vitin 2020. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm tridhjetë e katër (34) indikatorë të jetë transparente, në gjashtë (6) me transparencë të pjesshëm si dhe në katër (4) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Hanit Elezit është vlerësuar me shtatëdhjetë e katër (74) pikë apo vetëm 84.09% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Hanit Elezit është vlerësuar me zero (0) pikë edhe në këta indikatorë: mos ofrimi i informatave për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë, mos publikimi i borxhit publik komunal, nuk ka ofruar të dhënat në formatin "Open Data", mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët e komunës.

Komuna e Hanit Elezit, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i raportit nga kërkesat për qasje në dokumente publike, nuk ka afuar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve, mos publikimi në vecmas i borxhit publik komunal (lista e posaçme e pasqyrimit të borxheve komunale), nuk ka ofruar për cdo drejtori listën e hollësishme të shërbimeve dhe procedurave të marrjes së shërbimeve të tilla nga ana e drejtorive komunale.




Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës, mbetet në trendë të njëjta në përm-bushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komu-nale. Gjatë periudhës vlerësuese janar – qershor 2021 ka përm-bushur 82.23 % të indikatorëve vlerësues dhe kraha-suar me vitin 2020 pothuajse është e njëjta kjo përm-bushje me vetëm 82.95 %. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në tridhjetë e katër (34) indikatorë të jetë trans-parente, në pesë (5) me transparencë të pjesshëm si dhe në pesë (5) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është mak-simalja e vlerësimit, komuna e Prishtinës është vlerësuar me gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë e tre (73) pikë apo vetëm 82.23% kjo komunë ka arritur t'i përm-bushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës⁸, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përm-bushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as ko-

muna e Prishtinës nuk ka arritë të përm-bushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Prishtinës është vlerësuar me zero (0) pikë edhe në këta indikatorë: mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në kuvendin e komunës, mos përfshirja e ku-ventit të komunës në organizimin e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.

Komuna e Prishtinës, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos diskutimi i raporteve tre mn-u-jore financiare brenda afateve ligjore, mos publikimi i do-kumenteve në gjuhë zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytet-arëve dhe statutit të kërkesave të tyre, mos azhurnimi i ueb-faqes duke respektuar gjuhët zyrtare, mos publikimi i borx-hit publik në një dokument të veçantë, janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.




⁸ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës, gjatë periudhës vlerësuese janar-qershor 2021 ka një rritje në përmbushjen e indikatorëve vlerësues krahasuar me vitin 2020. Derisa gjatë vitit 2020 kishte përmbushur vetëm 72.92 % të indikatorëve gjatë kësaj periudhe ka përmbushur 80.68 % duke u renditur në top 10 komunat në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparimetit komunal. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në tridhjetë e dy (32) indikatorë të jetë transparente, në shtatë (7) me transparencë të pjesshëm si dhe në pesë (5) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Malishevës është vlerësuar me shtatëdhjetë e një (71) pikë apo vetëm 80.68% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës⁹, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Malishevës nuk ka arritë të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Malishevës është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: nuk janë të publikuara dokumentet dhe informatat e ndryshme në ueb faqen e komunës duke respektuar ligjin për gjuhët zyrtare, mos përfshirja e kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), nuk është publikuar Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021. Po ashtu, komuna e Malishevës ka vazhduar të mos ofrojë të dhënat në formatin "Open Data" si dhe nuk ka siguruar një lunjë telefonike pa pagesë për qytetarët e komunës.



⁹ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>



Bazuar në Udhëzimin Administrativ për transparencë në komuna¹⁰, komunat obligohen të hartojnë, miratojnë dhe publikojnë në ueb faqen e komunës Planin e veprimit për transparencë. Komuna e Malishevës në këtë indikatorë është vlerësuar pjesërisht transparente për shkak se bë ueb faqen e komunës është informacioni që ekziston Plani i veprimit për Transparencë 2021, por vegëza e tillë nuk e hapë dokumentin duke e bërë të pa përdorshëm këtë infomacion edhe përkundër tentativës së komunës së Malishevës për të përmbushur këtë indikator, shkak i pengesave të tilla teknikne, është vlerësuar si pjesërisht transparente. Komuna e Malishevës, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos publikimi i të gjitha video mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare brenda afateve kohore të përcaktuara me

legjislacion, mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për proceset që ndërlidhen me integrimet evropiane (përveç emrit të zyrtarit, emailit dhe numrit të telefonit asnjë e dhënë tjetër nuk është e publikuar), nuk ka publikuar raportin e kërkesave për qasje në dokumente publike edhe përkundër që komuna e Malishevës ka koordinatorin për qasje në dokumente publike, nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve si dhe mos publikimin e borgjit publik komunal, janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.

“ Komuna e Malishevës në këtë indikatorë është vlerësuar pjesërisht transparente për shkak se bë ueb faqen e komunës është informacioni që ekziston Plani i veprimit për Transparencë 2021, por vegëza e tillë nuk e hapë dokumentin duke e bërë të pa përdorshëm këtë infomacion edhe përkundër tentativës së komunës së Malishevës për të përmbushur këtë indikator, shkak i pengesave të tilla teknikne, është vlerësuar si pjesërisht transparente.

¹⁰Shihe nenin 15 Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31852>




Komuna e Suharekës

Edhe komuna e Suharekës, gjate periudhës vlerësuese janar – qershor 2021 ka rritje në përmbushjen e indikatorëve vlerësues krahasuar me vitin 2020. Derisa në vitin 2020 komuna e Suharekës kishte përmbushur vetëm 72.92 % të indikatorëve gjatë periudhës vlerësues aktuale ka një rritje prej 80.68 % të përmbushjes së indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në tridhjetë e katër (34) indikatorë të jetë transparente, në tre (3) me transparencë të pjesshëm si dhe në shtatë (7) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Suharekës është vlerësuar me shtatëdhjetë e një (71) pikë apo vetëm 80.68 % kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës¹¹, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Suharekës nuk ka arritë të përmbushë

këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Suharekës është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos azhurnimi i ueb faqes zyrtare në gjitha gjuhët zyrtare. Po ashtu, komuna e Suharekës ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira, nuk ka ofruar të dhënat në formatin "Open Data", nuk ka siguruar një lunjë telefonike pa pagesë për qytetarët e komunës, mos ofrimi i listës së hollësishme të shërbimeve që ofron institucini. Komuna e Suharekës, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta tre (3) indikatorë: mos publikimi i detajeve biografike për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës si dhe në njoftimeve në kohë për seancat e kuvendit të komunës, nuk ka afuar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve si dhe nuk ka ofruar një listë të hollësishme të ofrimit të shërbimeve nga ana e institucionit përkatësisht shumë drejtori komunale, nuk kanë një informatë të tillë.




¹¹ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>



Komuna e Ferizaj

Komuna e Ferizajt mbetet në mesin e komunave me një trend linear në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur 79.55% të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rritje të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 78.13 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në tridhjetë e dy (32) indikatorë të jetë transparente, në gjashtë (6) me transparencë të pjesshëm si dhe në gjashtë (6) indikatorë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Ferizajt është vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë apo vetëm 79.55 % kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për piakt e rendit të ditës¹², jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Ferizajt nuk ka arritë të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Ferizajt është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos thirrjen e kryetarit të komunës që të raportoj në Kuvend dhe në KPF për punën e tij në baza të rregulta, mos perfshirja e KPF përkatësisht kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), mos publikimi i Planit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2021, në të dhënat në formatin “Open Data”, si dhe komuna e junikunuk ka arritë që të ofrojë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët e saj.



¹² Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>





Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Ueb faqet e institucioneve publike¹³, institucionet publike ndër të tjera kanë për obligim të ofrojnë informata të mjaftueshme për ofrimin dhe procedurat e marrjes së shërbimeve nga institucioni. Komuna e Ferizajt në këtë indikatorë është vlerësuar pjesërisht transparentë për shkak se disa drejtori komunale kanë mungesë të informatave të përgjithshme në marrjen e shërbimeve të tilla. Me vlerësim të pjesshëm është vlerësuar edhe në katër (4) indikatorë të tjerë përkatësisht

në mos ofrimin e një mekanizmi paralel, ku qytetarët do të kishin mundësin e përcjelljes së statusit të kërkesave të tyre, mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për proceset dhe përmbushjen e obligimeve të nivelit lokal në proceset integruar evropiane, mos respektimin e gjuhëve zyrtare në azhurnimin e ueb faqes zyrtare të komunës, mos publikimi i borxhit publik komunal (publikimi i tillë mbetet parcial në kuadër të raporteve tre mujore financiare).

“ Komuna e Ferizajt është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos thirrjen e kryetarit të komunës që të raportoj në Kuvend dhe në KPF për punën e tij në baza të rregulta, mos perfshirja e KPF përkatësisht kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), mos publikimi i Planit të punës së Kryetarit të komunës për vitin 2021, në të dhënat në formatin “Open Data”, si dhe komuna e junikunuk ka arritë që të ofrojë një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët e saj.

¹³ Shihe nenin 9 paragrafin 1.13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>




Komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut mbetet në mesin e komunave me një trend linear në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur 78.41% të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rritje të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 77.08 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm tridhjetë e dy (32) indikatorë të jetë transparente, në pesë (5) me transparencë të pjesshëm si dhe në shtatë (7) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Kaçaniku është vlerësuar me gjashtëdhjetë e nëntë (69) pikë apo vetëm 78.41% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës¹⁴, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as ko-

Komuna e Parteshit mbetet në mesin e komunave me një trend linear në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale, duke përmbushur mesatarisht indikatorët vlerësues. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur 55.68 % të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rritje të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 48.96 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm shtatëmbëdhjetë (17) indikatorë të jetë transparente, në pesëmbëdhjetë (15) me transparencë të pjesshëm si dhe në dymbëdhjetë (12) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Parteshit është vlerësuar me Dyzet e nëntë (49) pikë apo vetëm 55.68% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës²⁶, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as

komuna e Parteshit nuk ka arritë të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Parteshit është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimi i video linçeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre në ueb faqen e komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të kryetarit të komunës në ueb faqen zyrtare, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqe, mos publikimi i borgjit publik komunal. Po ashtu, komuna e Parteshit ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira si dhe nuk ka publikuar të dhënat nga të hyrat vetanake të komunës.



²⁶ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>



Komuna e Parteshit, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos publikimi i njoftimeve në kohë për mbledhjet e kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mos publikimi i të dhënave biografike për të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimit për transparencë, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në baza të rregullta kohore, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos organizimi

i dëgjimeve buxhetore për KAB nga kuvendi i komunës, mos publikimi i informatave të mjaftueshme për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë, nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike etj. janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.

“ Komuna e Parteshit është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimi i video linçeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre në ueb faqen e komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të kryetarit të komunës në ueb faqen zyrtare, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqe, mos publikimi i borgjit publik komunal.




Komuna e Mamushës

Komuna e Mamushës mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 51.14 % të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 60.42 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm nëntëmbëdhjetë (19) indikatorë të jetë transparente, në nëntë (9) me transparencë të pjesshëm si dhe në shtatëmbëdhjetë (17) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Mamushës është vlerësuar me dyzet e pesë (45) pikë apo vetëm 51.14 % kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës²⁷, jo secili kuvendit i komunës ka arritur të përmbushë një obligim të tillë ligjor.

Kësisoj, as komuna e Mamushës nuk ka arritur të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Mamushës është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfiri: mos përkrahimi i shkurtër i historikut të komunës në ueb faqen e komunës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i Planit të veprimit për transparencë, mos publikimi i video linqeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale në ueb faqen e komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transpemtimit direkt i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës nga kuvendi në baza të rregullta kohore, mos përfshirja e kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen zyrtare. Po ashtu, komuna e Mamushës ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna



²⁷ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>



me qira, nuk ka ofruar të dhënat në formatin "Open Data", nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe nuk ka publikuar borxhin publik komunal në baza të rregullta.

Nuk janë publikuar njoftimet për thirrjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), nuk ka publikuar Planin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2021, nuk janë publikuar procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2021, mos percaktimi i personit përgjegjës si koordinator për kërkesat për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike nuk ka publikuar kontaktet e zyrarit dhe zyrës për informim si.

Komuna e Mamushës, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos publikimi i njoftimeve në kohë për mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), mos publikimi i të dhënave biografike për të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në baza të rregullta kohore, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos azhurnimi i ueb faqes zyrtare në gjitha gjuhët zyrtare, mos publikimi i borgjit publik komunal në formë të vecantë, nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.

“ Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Mamushës nuk ka arritë të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator.




Komuna e Mitrovicës Veriore

Komuna e Mitrovicës së Veriut, gjatë periudhës vlerësuese janar – qershor 2021 ka rritje në përmbushjen e indikatorëve vlerësues krahasuar me vitin 2020. Derisa në vitin 2020 kishte përmbushur 40.63 % të indikatorëve gjatë periudhës vlerësues aktuale ka një rritje të theksuar prej 48.86 % të përmbushjes së indikatorëve vlerësues. Megjithatë, komuna e Mitrovicës së Veriut mbetet në mesin e komunave që janë vlerësuar nën 50 % në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm trembëdhjetë (13) indikatorë të jetë transparente, në pesëmbëdhjetë (15) me transparencë të pjesshëm si dhe në gjashtëmbëdhjetë (16) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Mitrovicës së Veriut është vlerësuar me katër dhjetë e tri (43) pikë apo vetëm 48.86% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Mitrovicës së Veriut është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë, përshfirë: mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimit për transparencë, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale në ueb faqen e komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale në ueb faqen e komunës,

mos publikimi i dokumenteve në gjuhë të zyrta, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës, mos publikimi i borgjit publik komunal. Po ashtu, komuna e Mitrovicës së Veriut ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira, mos publikimi i të dhënave vetanake, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e "Open Data", mos publikimi i kontaktit të zyrta për informim, nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, mos publikimi i buxhetit komunal për vitin 2021 në ueb faqen e komunës.

Komuna e Mitrovicës së Veriut, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos mbajtja e seancave të kuvendit të komunës de KPF-së sipas legjislacionit (indikator 1, 2, 3 dhe 4), mos publikimi i gjitha procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës dhe drejtorët komunal nga kuvendi dhe KPF, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhë të zyrta, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë përcjellës të statusit të kërkesave të qytetarëve, mos azhurnimi i ueb faqes në gjuhë të zyrta etj. janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.






Komuna e Shtërpces

Komuna e Shtërpçës mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janë – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 48.86% të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 54.17% të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm tetëmbëdhjetë (18) indikatorë të jetë transparente, në shtatë (7) me transparencë të pjesshëm si dhe në nëntëmbëdhjetë (19) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Shtërpçës është vlerësuar me katër dhjetë e tri (43) pikë apo vetëm 48.86% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Shtërpçës është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë, përshfirë: mos njohimi i qytetarëve për mbledhjet e KPF-së, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i video linçeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre në ueb faqen e komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos publikimi i Rregulloreve komunale, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e drejtorëve komunal nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të

kryetarit të komunës në ueb faqen zyrtare, mos zyrtarizimi i koordinorit për qasje në dokumente publike si dhe mos publikimi i raportit të kërkesave për qasje në dokumente publike, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mos publikimi i borgjit publik komunal. Po ashtu, komuna e Shtërpçës ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e "Open Data", nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, nuk ka ofruar një listë të hillësishme për shërbimet dhe procedurat e marrjes së shërbimeve nga institucioni si dhe nuk ka organizuar takimet publike sipas legjislacionit në fuqi. Komuna e Shtërpçës, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos mbajtja e seancave të kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i gjithë procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendit, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë drejtorët, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë përcjellës të statusit të kërkesave të qytetarëve, mos azhurnimi i ueb faqes në gjuhët zyrtare, janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.




Komuna e Klllokotit

Komuna e Klllokotit mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 47.73% të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 54.17% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Klllokotit, gjatë periudhës vlerësuese nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm gjashtëmbëdhjetë (16) indikatorë të jetë transparente, në dhjetë (10) me transparencë të pjesshëm si dhe në tetëmbëdhjetë (18) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Klllokotit është vlerësuar me katër dhjetë e dy (42) pikë apo vetëm 47.73% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës²⁸, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Klllokotit nuk ka arritë të përmbushë

këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Klllokotit është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimi i të dhënave biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos përshkrimii i një historiku të shkurtër për komunën në ueb faqen e komunës, mos publikimi i video linçeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre në ueb faqen e komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të kryetarit të komunës në ueb faqen zyrtare, mos publikimi i detajeve biografike të drejtorëve të drejtorive komunale në ueb faqen zyrtare, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i borgjit publik komunal, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e "Open Data", nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, nuk ka publikuar kontaktet e Zyrës për Informim.



²⁸Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>



Komuna e Klokotit, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos informimi sipas legjislacionit për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos informimi sipas legjislacionit për mbajtjen e mbledhjeve të komitetit, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i raportit nga kërkesat për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për për regjistrimin e kërkesave të

qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre, mos azhurnimi i plotë i ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos publikimi i gjitha vendimeve të kryetarit në ueb faqe, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqës etj. janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.

“ Komuna e Klokotit, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos informimi sipas legjislacionit për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos informimi sipas legjislacionit për mbajtjen e mbledhjeve të komitetit, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i raportit nga kërkesat për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre, mos azhurnimi i plotë i ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos publikimi i gjitha vendimeve të kryetarit në ueb faqe, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqës etj.




Komuna e Zveçanit

Komuna e Zveçanit mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 46.59% të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 54.17% të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm trembëdhjetë (13) indikatorë të jetë transparente, në pesëmbëdhjetë (15) me transparencë të pjesshëm si dhe në gjashtëmbëdhjetë (16) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Zveçanit është vlerësuar me katër dhjetë e një (41) pikë apo vetëm 46.59% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Zveçanit është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë, përshfirë: mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimit për transparencë, mos publikimi i Rregulloreve komunale në ueb faqen e komunës, mos përfshirja e kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore për KAB, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i

vendimeve të kryetarit të komunës, mos publikimi i borgjit publik komunal. Po ashtu, komuna e Zveçanit ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e "Open Data", mos publikimi i kontaktit të zyrtarit për informim, nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, mos publikimi i buxhetit komunal për vitin 2021 në ueb faqen e komunës.

Komuna e Zveçanit, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos mbajtja e seancave të kuvendit të komunës de KPF-së sipas legjislacionit (indikatorit 1, 2, 3 dhe 4), mos publikimi i aktiviteteve në ueb faqen e komunës, mos publikimi i gjithë procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendit, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës dhe drejtorët komunal nga kuvendi dhe KPF, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare brenda afateve kohore, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë përcjellës të statusit të kërkesave të qytetarëve, mos azhurnimi i ueb faqes në gjuhët zyrtare etj. , janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.




Komuna e Leposaviq

Komuna e Zveçanit mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 45.45% të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 55.21 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm trembëdhjetë (13) indikatorë të jetë transparente, në katërbëdhjetë (14) me transparencë të pjesshëm si dhe në shtatëmbëdhjetë (17) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Komuna e Leposaviqit është vlerësuar me katër dhjetë (40) pikë apo vetëm 45.45% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Leposaviqit është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë, përshfirë: mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimit për transparencë, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos publikimi i Rregulloreve komunale, mos publikimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të drejtorëve komuna në ueb faqen zyrtare, mos zyrtarizimi i koordinatorit për qasje në dokumente publike si dhe mos


publikimi i raportit të kërkesave për qasje në dokumente publike, Mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mos publikimi i borgjit publik komunal. Po ashtu, komuna e Leposaviqit ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje në të hyrat vetanake, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e "Open Data", nuk ka ofruar një ëë telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe nuk ka organizuar takimet publike sipas legjislacionit në fuqi. Komuna e Leposaviqit, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos thirrja e seancave të kuvendit të komunës sipas legjislacionit (indikator 1, 2, 3, 4), mos publikimi i gjithë procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendit, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në baza të rregullta nga ana e kuvendit, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë përcjellës të statusit të kërkesave të qytetarëve, mos azhurnimi i ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos publikimi i listës për shërbimet dhe procedurat e marrjes së shërbimeve nga ana e drejtorive komunale, publikimi i pjesshëm i aktiviteteve në ballinën e ueb faqes, publikimi i në rubrikë jo adekuate i buxhetit të komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.



Komuna e Novobërdës

Komuna e Novobërdës mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përbushur vetëm 42.05 % të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përbushur 56.25 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm trembëdhjetë (13) indikatorë të jetë transparente, në njëmbëdhjetë (11) me transparencë të pjesshëm si dhe në njëzet (20) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Novobërdës është vlerësuar me tridhjetë e shtatë (37) pikë apo vetëm 42.05% kjo komunë ka arritur t'i përbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe. Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës²⁹, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përbushë një obligim të tillë ligjor. Kësisoj, as komuna e Novobërdës nuk ka arritë të përbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Novobërdës është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimi i thirrjeve për KPF sipas legjislacionit, mos përshkrimi i një historiku të shkurtër për komunën në ueb

faqen e komunës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të vperimit për transparencë, mos publikimi i video linçeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre në ueb faqen e komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale nga kuvendi i komunës, mos publikimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i borxhit publik komunal, mos publikimi i listës së pronave komunale të dhëna me qira, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e "Open Data", nuk ka publikuar kontaktet e Zyrës për Informim si dhe nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët. Komuna e Novobërdës, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore, mos publikimi i detajeve biografike për gjithë drejtorët e drejtorive komunale, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike etj. janë indikatorë që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.



²⁹ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>




Komuna e Ranillugut

Komuna e Ranillugut mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 40.91 % të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 48.96 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm dymbëdhjetë (12) indikatorë të jetë transparente, në dymbëdhjetë (12) me transparencë të pjesshëm si dhe në njëzet (20) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Ranillugut është vlerësuar me tridhjetë e gjashtë (36) pikë apo vetëm 40.91% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Informimi i qytetarëve për punën e kuvendit të komunës mbetet parakusht për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Të obliguar në ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës³⁰, jo secili kuvendit i komunës ka arritë të përmbushë një obligim të tillë ligjor.

Kësisoj, as komuna e Ranillugut nuk ka arritë të përmbushë këtë obligim ligjor, duke u vlerësuar me zero pikë në këtë indikator. Po ashtu, komuna e Ranillugut është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë tjerë përshfirë: mos publikimi i të dhënave biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos përshkrimii i një historiku të shkurtër për komunën në ueb faqen e komunës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i video linçeve të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre në ueb faqen e komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të kryetarit të komunës në ueb faqen zyrtare, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i borgjit publik komunal.



³⁰ Shih nenin 43, paragrafin 3, pikën e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>





Po ashtu, komuna e Ranillugut ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira si dhe nuk ka publikuar të dhënat nga të hyrat vetanake të komunës, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e “Open Data”, nuk ka publikuar kontaktet e Zyrës për Informim, nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve.

Komuna e Ranillugut, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: vendimet e kuvendit të komunës, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore për KAB nga kuvendi i komunës, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqës etj. janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.


“ Komuna e Ranillugut ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira si dhe nuk ka publikuar të dhënat nga të hyrat vetanake të komunës, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e “Open Data”, nuk ka publikuar kontaktet e Zyrës për Informim, nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, nuk ka afruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve.



Komuna e Zubin Potok

Komuna e Zubin Potokut mbetet në mesin e komunave që ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Gjatë kësaj periudhë vlerësuese janar – qershor 2021 ka përmbushur vetëm 36.36 % të indikatorëve dhe krahasuar me vitin 2020 kemi një rënie të vogël meqenëse gjatë vitit 2020 kishte përmbushur 44.79 % të indikatorëve vlerësues. Nga dyzet e katër (44) indikatorë, ka rezultuar që në vetëm nëntë (9) indikatorë të jetë transparente, në katërmëdhjetë (14) me transparencë të pjesshëm si dhe në njëzet e një (21) indikatorë tjerë të mos ofrojë transparencë fare. Në vlerësimin e përgjithshëm, nga 88 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, komuna e Zubin Potokut është vlerësuar me tridhjetë e dy (32) pikë apo vetëm 36.36% kjo komunë ka arritur t'i përmbushë indikatorët vlerësues gjatë kësaj periudhe.

Komuna e Zubin Potokut është vlerësuar me zero pikë edhe në disa indikatorë, përshfirë: mos njofimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mos përshkrimi i një historiku të shkurtër për komunën ne ueb faqe, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimit për transparencë, mos publikimi i Rregulloreve komunale, mos publikimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i informatave për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë, mos zyrtarizimi i koordinitorit për qasje në dokumente publike si dhe mos publikimi i raportit të kërkesave për qasje në dokumente publike, mos kthimi i kërkesave për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës për vitin 2021, mos publikimi i vendimeve të kryetarëve të komunës, mos publikimi i borgjit publik komunal.





Po ashtu, komuna e Zubin Potokut ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira, mos publikimi i të hyrave vetanake të komunës, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e “Open Data”, nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, nuk ka ofruar një listë të hillësishme për shërbimet dhe procedurat e marrjes së shërbimeve nga institucioni, nuk ka organizuar takimet publike sipas legjislacionit në fuqi si dhe nuk ka publikuar buxhetin e komunës në ueb faqe.

Komuna e Zubin Potokut, pjesërisht transparente është treguar edhe në këta indikatorë: mos mbajtja e seancave të kuvendit të komunës de KPF-së sipas legjislacionit (indikator 2, 3 dhe 4), mos publikimi i të gjitha draft Rregulloreve komunale, mos publikimi i gjithë procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendit, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës dhe drejtorët komunal nga kuvendi dhe KPF, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë drejtorët, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë përcjellës të statusit të kërkesave të qytetarëve, mos azhurnimi i ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos publikimi i kontakteve të zyrtarit për informim, mos publikimi i gjithë aktiviteteve në ueb faqen e komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me vetëm një (1) pikë.

“ Komuna e Ranillugut ka vazhduar të mos ofroj publikut qasje edhe në listën e pronave të dhëna me qira si dhe nuk ka publikuar të dhënat nga të hyrat vetanake të komunës, nuk ka publikuar të dhënat në formatin e “Open Data”, nuk ka publikuar kontaktet e Zyrës për Informim, nuk ka ofruar një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, nuk ka ofruar një mekanizëm shtesë përcjellës për të mbikqyrë të statusit të kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve.





REKOMANDIMET

➤ Të hapen të dhënat në formatin e “Open Data”.

Nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, vetëm komuna e Prishtinës ka formatin e të dhënave Open Data dhe komuna e Gjakovës pjesërisht.

➤ Të bashkëngjitet në thirrjet e seancave të kuvendit të komunës edhe materiali përcjellës për pikat e rendit të ditës.

Rekomandohen komunat: Dragash, Prishtinë, Ferizaj, Suharekë, Gjilan, Istog, Obiliq, Shtimje, Podujevë, Novo Bërdë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Malishevë, Prizren, Mamushë, Klinë, Deçan dhe Kaçanik që me qëllim të informimit dhe përfshirjes së qytetarëve në punën dhe vendimmarrjen e kuvendit të komunës, komunat në fjalë duhet të fillojnë të praktikojnë ofrimin e materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës në ueb faqen e komunës. Kjo praktikë, bënë që komunat të zbatojnë në plotëni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

➤ Të publikohet Plani i punës së kuvendit të komunës.

Rekomandohen komunat si: komuna Dragash, Gjakovë, Graçanicë, Zubin Potok, Shtërpce, Zveçan, Laposaviç, Mitrovicë Veriore, Obiliq, Shtime, Novo Bërdë, Ranillug dhe Mamushë që për çdo vit kalendarik duhet të publikoj Planin e punës në ueb faqen e komunës. Hartimi dhe miratimi i Planit të punës së kuvendeve mbetet kusht ligjor, i cili duhet të jetë i qasshëm edhe në ueb faqen e komunës.

➤ Të publikohet Plani i Veprimit për transparencë.

Rekomandohen komunat: Zubin Potok, Zveçan, Laposaviç Mitrovicë Veriore, Istog, Novo Bërdë,, Fushë Kosova, Mamushë, dhe Mamushë që të publikojnë Planin e Veprimit për Transparencë komunale.

➤ Komuna të respektojë ligjin për gjuhët, duke ofruar qasje në të gjitha gjuhët zyrtare.

Rekomandohen komunat si: komuna Suharekë, Laposaviç, Mitrovicë e Veriut, Shtime, Novo Bërdë, Malishevë, Deçan, Junik dhe Kaçanik që ti përmbushin obligimet ligjore në respektim të ligjit në gjuhë zyrtare

➤ Kuvendi i komunës të përfshihet në organizmin e dëgjimeve për KAB.

Rekomandohen komunat si: komuna Dragash, Vushtrri, Ferizaj, Graçanicë, Prishtinë, Zubin Potok, Shtërpce, Zveçan, Laposaviç, Mitrovicë Veriore, Istog, Obiliq, Lipjan, Podujevë, Novo Bërdë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Viti, Fushë Kosovë, Skenderaj, Prizren, Malishevë, Klinë, Junik dhe Kaçanik. Përfshirja e KK-së në organizimet buxhetore do të mundësonte që kuvendi i komunës si organ më i lartë vendimmarrës në nivel lokal të ketë rol aktiv në planifikimet buxhetore por do të siguronte edhe në përmbushjen e obligimeve ligjore në përfshirjen e kuvendit në proceset e konsultimit publik të politikave buxhetore.





> **Të publikohen informatat në organizimin dhe konsolidimin e Këshillave Lokal.**

Rekomandohen komunat si: Dragash, Vushtrri, Graçanicë, Zubin Potok, Shtërpçë, Zveçan, Leposaviç, Mitrovicë Veriore, Iatog, Oboliq, Lipjan, Podujevë, Novo Bërdë, Ranillug, Partesh, Klllokot, Viti, Fushë Kosovë, Skenderaj, Prizren, Mamushë, Klinë, Junik dhe Kaçanik duhet të shtojnë përpjekjet në rritjen e bashkëpunimit (organizimi i takimeve) me Këshillat Lokal si një ndër mekanizmat institucional në nxitjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Po ashtu, publikimi i aktiviteteve dhe të dhënave për Këshillat Lokal mundësojnë një qasje pro aktive të komunikimit të qytetarëve dhe palëve tjera të interesit me këta mekanizma.

> **Të rritet transparencja e komunës në rolin dhe angazhimin e tyre rreth proceseve integruuese evropiane.**

Rekomandohen komunat si: Graçanicë, Zubin Potok, Obiliq, Shtime, Ranillug, Viti, Klinë, Deçan, Junik, Kaçanik dhe Hani Elezit të respektojnë obligimet në përmbushjen e agjendës evropiane. Këto zyra institucionale kanë për obligim të raportojnë në baza të rregullta në nivelin qendror në përmbushjen e agjendës evropiane. Megjithatë, pak komuna vazhdojnë të ofrojnë informata për qytetarët sa i përket përmbushjes së obligimeve të tilla. AQT rekomandon komunat si më lartë, që të publikojnë informatat dhe raportet e ndryshme nga niveli lokal në arritjen e përmbushjes së agjendës evropiane.

> **Të publikohet Plani i punës të Kryetarit për 2021.**

Rekomandohen komunat si: Ferizaj, Prishtinë, Zubin Potok, Shtërpçë, Suharekë, Obiliq, Istog, Shtime, Podujevë, Novo Bërdë, Ranillug, Partesh, Klllokot, Fushë Kosovë, Malishevë dhe Mamushë që të bëjnë publikimin e planeve vjetore të punës së kryetarëve. Publikimi i Planit të punës së kryetarit, do të rriste mundësitë e përfshirjes së qytetarëve në procesin e monitorimit të zbatimit të Planit të punës. Kjo qasje do të rriste mundësitë e ofrimit të llogaridhënies më të madhe të ekzekutivit në zbatimin e Planeve vjetore por edhe në respektimin e legjislacionit që obligon kryetarët e komunave të publikojnë Planet e punës.

> **Të ofrohet një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët.**

Rekomandohen komunat si: Dragash, Ferizaj, Gjakovë, Zubin Potok, Shtërpçë, Suharekë, Zveçan, Leposaviç Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Kamenicë, Istog, Obliq, Shtime, Novo Bërdë, Ranillug, Klllokot, Viti, Fushë Kosovë, Skenderaj, Mamushë, Klinë, Deçan, Junik, Malishevë, dhe Hani i Elezit që të ofrojnë mundësinë e komunikimit shtesë me qytetarët të cilat nuk kanë kosto financiare. AQT rekomandon komunat e lartcekura që të ofrojnë linjë direkte telefonike pa pagesë, ku qytetarët do të kenë mundësitë e pasqyrit të shqetësimeve dhe kërkesave eventuale pa ndikim financiar për ekonominë familje.

> **Të publikohet lista e pronave komunale të dhëna me qira.**

Rekomandohen komunat si: Dragash, Gjakovë, Novo Bërdë, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klllokot, Viti, Fushë Kosovë, Mamushë, Klinë, Pejë, Deçan, Junik, Hani i Elezit, Zubin Potok, Shtërpçë, Suharekë, Zveçan, Leposaviç, Mitrovicë e Veriut, Kamenicë, Obiliq dhe Shtime, që të bëjnë publike listat e pronave komunale të dhëna me qira.





Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020, në përbërje të disa organizatave lokale duke përfshirë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe me anëtarë të rinj për të mbuluar komunat e rajonit të Prishtinës (Initiative for Social Education - ISEP), komunat e rajonit të Ferizajt (OJQ Avonet), komuna e rajonit të Gjakovës (SHL-Kosova), komunat e rajonit të Prizrenit (OJQ Sofra). AQT ka për synim të avokoj dhe lloboj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale.

Me përkrahjen financiare të:

